



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 1313/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha kryesues, Xhevdet Abazi dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën e Afërdita Lajçi, në cilësinë e Kandidates për Anëtare të Kuvendit Komunal në Pejë, nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) në Pejë, paraqitur kundër shpalljes së rezultateve përfundimtare nga QNR-KQZ, për Zgjedhjet Lokale në seancën e panelit të mbajtur me 27.12.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Afërdita Lajçi, në cilësinë e Kandidates për Anëtare të Kuvendit Komunal në Pejë nga radhët e PDK-së.

Arsyetim

PZAP-i, me datë 24.12.2013 ka pranuar një ankesë nga Afërdita Lajçi ku ka pretenduar se në Qendrat e Votimit si në: QV1701c, QV1702c, QV1703c, QV1704x, QV1704c, QV1705c, QV1706c, QV1708c, QV1710c, QV1711c, QV1714c, QV1726c, QV1727c dhe QV1705x”, i janë marrë votat me apo pa qëllim, si dhe dyshon se këto manipulime janë bërë nga ana e komisionerëve gjatë numërimit të votave.

Parashtruesja e ankesës nuk ka bashkangjitur asnjë dëshmi si provë.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

ankesa është e pabazuar

PZAP-i, konstatoi se pretendimet ankimore të kandidates për Anëtare të Kuvendit Komunal në Pejë, Afërdita Lajçi janë të pa argumentuara në fakte dhe dëshmi konkrete pasi që ankesës në fjalë nuk i ka bashkangjitur asnjë dëshmi bindëse si provë për tu vërtetuar për shkeljen e supozuar andaj ankesa vlerësohet si e pa bazë, duke u bazuar në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lartë përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 1313/2013 më datën 27.12.2013.

Kryesuesi i Panelit
Muhamet Rexha



Këshillë Juridike: Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda 24 orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.